



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, 7 Prill 2026

Subjekti: Shqetësime mbi përputhshmërinë me standardet e BE-së në fushën e transportit dhe konkurrencës

Drejtuar: Komisionerit për Transport dhe Konkurrencë, Apostolos Tzitzikostas
Komisionerit për Konkurrencën, Teresa Ribera

Të nderuar Komisionerë,

Ju drejtohem në cilësinë time si Nënkyetare e Komisionit të Stabilizim-Asociimit në Kuvendin e Shqipërisë për të sjellë në vëmendjen tuaj një nismë ligjore që, sipas vlerësimit tim, ngre shqetësime të rëndësishme në fushat që mbulon, përkatësisht politika e transportit dhe konkurrencës, si dhe në raport me përputhshmërinë e saj me standardet e Bashkimit Europian në kuadër të procesit të integritimit.

Amendimi i propozuar në ligjin për portet turistike parashikon që, në rastet kur një projekt pajiset me statusin "investim strategjik", investitori mund të ndërtojë dhe operojë portin turistik drejtpërdrejt, pa iu nënshtuar procedurave konkurruese apo koncesionare, ndërkohë që elementë të rëndësishëm të këtij procesi delegohen për t'u përcaktuar përmes vendimeve të mëtejshme të Këshillit të Ministrave.

Nga këndvështrimi i konkurrencës, kjo qasje ngre shqetësime në dritën e Nenit 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili kërkon shmangien e çdo mase që mund të shtrembërojë konkurrencën. Dhënia e të drejtave ekskluzive një subjekti të vetëm, jashtë çdo procedure të hapur dhe konkurruese, rrezikon të krijojë avantazhe selektive dhe të përjashtojë operatorët e tjerë nga tregu, duke dobësuar parimet e konkurrencës së ndershme dhe të barazisë së kushteve.

Në të njëjtën kohë, kjo nismë ngre shqetësime edhe në raport me parimet e Kapitullit 5 (Prokurimi Publik), ku procedurat e hapura, transparenca dhe trajtimi i barabartë janë thelbësore për menaxhimin e aseteve publike.

Nga këndvështrimi i transportit, propozimi prek drejtpërdrejt mënyrën e menaxhimit dhe zhvillimit të infrastrukturës portuale, e cila në vendet e Bashkimit Europian konsiderohet pjesë e infrastrukturës strategjike dhe i nënshtrohet kuadrove të qarta rregullatore që garantojnë akses jo-diskriminues, transparençë dhe mbikëqyrje efektive. Integrimi i të drejtave për zhvillimin e një porti brenda një projekti privat, pa procedura konkurruese, përbën një devijim nga këto parime dhe nga praktikatat e konsoliduara europiane.

Gjithashtu, kjo qasje zbeh dallimin ndërmjet investimeve private dhe infrastrukturës publike, duke rrezikuar që asete me interes të përgjithshëm të trajtohen si pjesë e marrëveshjeve të mbyllura, pa garanci të mjaftueshme për transparencë dhe llogaridhënie.

Në kuadër të procesit të integritit evropian dhe të detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, konsideroj se është thelbësore që çdo nismë e tillë të vlerësohet me kujdes në raport me acquis të BE-së dhe me standardet që Shqipëria është angazhuar të zbatojë.

Në këtë kontekst, do të vlerësoja shumë çdo mendim, orientim apo vlerësim që mund të ofroni mbi përputhshmërinë e këtij modeli me standardet e Bashkimit Evropian dhe mbi implikimet e tij për procesin e mëtejshëm të integritit.

Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm, mbetem e gatshme për çdo informacion shtesë apo diskutim të mëtejshëm mbi këtë çështje.

Me respekt,

Jorida TABAKU

Nënkryetare

Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit